REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 349/19
Datë/Datum. 05.7.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna e Podujevës** OE ankues **NNP "Arhiko.ing"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP **Nr.349/19**
Prej:	Ekspert shqyrtues i prokurimit **Muhamet Kurtishaj**		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me **Nr.349/19** të parashtruar nga OE **NNP "Arhiko.ing"**- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i Projeteve"** me nr. prok. 615-19-1401-221		
Datë	05.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e **dt:27.06.2019** me **nr.349/19** të parashtruar nga OE **NNP "Arhiko.ing"**- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i Projeteve"** me nr. prok. 615-19-1401-221, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Komuna e Podujevës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		02.07.2019	**05.07.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 27.06.2019 OE **NNP "Arhiko.ing"- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhenie të kontratës lidhur me aktivitetit te prokurimit **"Hartimi i Projeteve"** me nr. prok. 615-19-1401-221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Podujevës**.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues **NNP "Arhiko.ing"- Prishtinë**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:
- Neni 7 i LPP-së (Barazia në trjatim-Jo/diskriminimi)
- Neni 10 i LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës
- Neni 11 i LPP-së (Informatat Sekree Afariste
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 65 i LPP-së (Pranueshmeria e kandidateve dhe tenderuesve)
- Neni 66 i LPP-së (Përshtatshmëria profesionale)
- Neni 69 i LPP-së (Aftësitë teknike dhe/ose Profesionale)
- Neni 33 i RRUOPP- Dorëzimi elektronik i tenderëve
- Neni 3.12 i RRUOPP

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Ne kemi kerkuar qasje me date: 12.06.2019.
Gjate qasjes ne dokumentacion kemi pasur problem sepse nuk na eshte lejuar shikim dokumentacionit te kompanise te shpallur fituese.
AK ka bere shkelje te nenit 10 te LPP qe garanton transparencen e gjithe procesit. Poashtu ka bere shkelje te nenit 11 qe cakton kushtet se si nje dokumentacion klasifikohet si sekret afarist. Kete e ka bere duke shpallur dokumentacionin e kompanise se shpallur fituese si dokumente sekrete afariste pa i plotesuar kushtet e percaktuara ne në këtë nen të LPP-së. Rrjedhimisht neve nuk na eshte deshmuar qe kompania e shpallur fituese ploteson kerkesat dhe jemi te detyruar qe te ankohemi ne te gjitha pikat dhe kerkesat e dosjes se tenderit.

Poashtu OE i dyti me rradhe "Studio Hapesira" SHPK nuk i ploteson kerkesen 9.1 &9.2 te FTD ku thuhet qe lideri i koncersiumit duhet te kete 60% te shumes se kerkuar ne pune te ngjashme të realizuara ne tre vitet e fundit. Rdeshimisht ky OE eshte dashur te eliminohet e jo te shpallet i pasuksesshem siç ka vepruar AK. Me kete ka bere shkelje te nenit 59 dhe nenit 66 dhe 69 to LPP.

Gjithashtu si verejtje e kemi qe ne dokumentacinin e ofruar te "Studio Hapesira" SHPK nuk kemi pare CV-te e stafit dhe nuk e dime nese ketij OE i mungojne CV- apo AK ka harruar të na ofroje per kontrollim.

Bazuar ne agumentet e dhena me larte, kerkojme nga AK te rishqyrtoje vendimet dhe to kontrolloje edhe njehere dokumentacionin e kompanive ofertuese, pasiqe ne dyshojme qe OE e shpallur fituese ka prezantuar staf qe nuk i ploteson kriteret per marrjen e kesaj kontrate, andaj per këte arsye ka kerkuar qe dosja te mbyllet qe mos te kene qasje kompanite tjera.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 25.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Kontratë publike shërbime/mesme
Vlera e parashikuar e kontratës:.....60.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....çmimi më i ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....15.04.2019
Data e hapjes së ofertave..... .....15.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....11.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të **pa suksesshëm**.....11.06.2019
Data e njoftimit për **dhënie** e kontratës:.....11.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....17.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....18.06.2019

Kriteret për vlerësim:
Çmimi më i ulët.

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të LPP-së.
2. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës
3. Vërtetimi nga Gjykata kompetente

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në aneksin 2.
2. Një vërtetim nga ATK në vendin e themelimit të OE se OE në fjalë nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Vlenë për OE fitues.
3. Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se OE nuk është i falimentuar apo likuiduar. Vlenë për OE fitues.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional komercial apo regjistrin e ndërmarrjeve Certifikatë e numrit fiskal.
2. Çertifikata e numrit fiskal.
3. Çertifikata për regjistrim në TVSh.
4. Çertifikata ISO 27001.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Certifikata e biznesit (kopje).
2. Certifikata e numrit fiskal (kopje).
3. Certifikata e TVSH (kopje).
4. Certifikata ISO 27001 kopje e noterizuar.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

E duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 115,000.00euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Sipas nenit 68 pika 1.5, deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Projektet e realizuara (të natyrës së ngjajshme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 85,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit.
2. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier i diplomuar ose master i Arkitekturës, përvoja e punës minimumi 3 vite pas diplomimit.
3. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, përvoja e punës minimumi 3 vite pas diplomimit.
4. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtaris drejtimi hidroteknik, përvoja e punës minimumi 3 vite pas diplomimit.
5. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Gjeodezisë, përvoja e punës minimumi 2 vite përvojë pune.
6. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier i diplomuar ose master i elektros, përvoja e punës minimumi 3 vite pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeqare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar shërbimet e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së shërbimeve, bashkangjitur referenca ose çertifikatë ose raporte të pranimit.
2. Për ingjinierin e arkitekturës të sillet kopja e diplomës e noterizuar, CV-ja, kontrata e punës di dhe dëshmi mbi përvojën e punës.
3. Për ingjinierin e konstruktiv të sillet kopja e diplomës e noterizuar, CV-ja, kontrata e punës di dhe dëshmi mbi përvojën e punës.
4. Për ingjinierin e hidroteknikës të sillet kopja e diplomës e noterizuar, CV-ja, kontrata e punës di dhe dëshmi mbi përvojën e punës.
5. Për ingjinierin e Gjeodezisë të sillet kopja e diplomës e noterizuar, CV-ja, kontrata e punës di dhe dëshmi mbi përvojën e punës.
6. Për ingjinierin e elektros të sillet kopja e diplomës e noterizuar, CV-ja, kontrata e punës di dhe dëshmi mbi përvojën e punës.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	"3D Projekt"	Prishtinë	1.33 €	JO
2.	"Infra-Plus"	Prishtinë	1.96 €	JO
3.	"Arhiko.ing"	Prishtinë	1.10 €	JO
4.	"Proing & Partners"	Prishtinë	0.64 €	JO
5.	"Eng-Idea"	Suharekë	4.52	JO
6.	"Studio Hapësira"	Prishtinë	0.67	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për rivlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Faik Gashi – Kryetar i komisionit
- Hanushe Gjata- Latifi – Anëtar i komisionit
- Naxhije Hasani – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vleresimit te Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë:

- Operatorine Ekonomik **"Proing & Partners"** me vlerën e ofertës **0.64 €.**

Deklarate:

Komisioni në përbërje të plotë pas vlerësimit, ekzaminimit të të gjitha ofertave ka konstatuar se çmimi më i lirë i plotëson kushtet e kërkuara në DT është operatori ekonomik "Proing & Partners" dhe si i tillë komisioni rekomandon që ky operatori ekonomik të shpërblehet me kontratë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Arhiko.ing" - Prishtinë

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës) dhe nenit 11 të LPP-së (Informatat sekrete afariste) sepse gjatë procesit të çasjes në dokumentet e OE fitues nuk ka garantuar transparencë duke e shpallë dokumentacionin e kompanisë fituese si dokument sekret afarist pa i plotësuar kushtet e parapara në këtë nen, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Operatori ekonomik ankues me datën 11.06.2019 ka kërkuar nga AK ti ofroj çasje në dokumentet e ofertës së OE fitues. Autoriteti kontraktues këtë çasje ja ka ofruar me datën 12.06.2019 OE ankues në dokumentet e ofertës së OE fitues. Pra sipas nenit 10 të LPP-së çasja i është dhënë OE ankues. Mirëpo autoriteti kontraktues ka bërë një klasifikim të dokumenteve të ofertës së OE fitues në përputhje me nenin 11 pragrafi 3 të LPP-së, të cilat dokumente kanë të bëjnë me kërkesat e nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe në këto dokumente nuk ju ka dhënë çasja OE ankues.

Çasja në këto dokumente nuk i është dhënë OE ankues për shkak se OE fitues ka plotësuar kërkesën sipas Aneksit 3 të dosjes së tenderit dhe në këtë kërkesë është theksuar që autoriteti kontraktues këto dokumente ti mbaj si sekret afarist i kompanisë.

Veprimi i autoritetit kontraktues në këtë rast është në përputhje me nenin 11 paragafit 3 i LPP-së.

Qëndrim të njëjtë ka mbajtur edhe KRPP-ja në përgjigjëjen e pyetjes që i është bërë nga OE ankues lidhur me klasifikimin e dokumentacionit sekret afarist.
KRPP në kuadër të përgjigjëjes së datë 20.06.2019 që i kthen OE ankues për këtë çështje ndër të tjera thotë: *"Informatat sekrete afariste mund të kërkohen që të klasifikohen nga AK vetëm dëshmit e ofruara lidhur me kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dëshmit lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale por asesi e gjithë oferta"*

Nga kjo dëshmohet se AK ka pasur të drejtë që i ka kalsifikuar dokumentet e OE fitues, që kanë të bëjnë me aftësit teknike dhe/ose profesionale (referencat, listën e projekteve, listën e puntorëve, diplomat etj.) pra që lidhen me kërkesat e neni 68 dhe 69 të LPP-së siç e parasheh neni 11 i LPP-së për informata sekrete afariste, ndërsa çasja është dhënë në dokumentet e tjera të ofertës. Nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin 2.
Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se OE me radhë "Studio Hapësira" nuk i plotëson kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT që lideri i konzorciumit duhet të ketë 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjshme te realizuar në tri vitet e fundit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Gjatë shqyrtimit të ofertës së OE "Studio Hapësira" shihet se me ofertë
ka të bashkangjitur listën e projekteve të realizuara të natyrës së ngjashme me projektin e AK-së. Lista e projekteve të ofruara e përmbushën kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT. Shumica e kontratave te realizuara nga ky Operator Ekonomik janë pikrishtë ne hartimin e projekteve. Lista e projekteve me referenca dhe raporte te pranimit të punimeve të OE "Studio Hapësira" është e bashkangjitur edhe në platformën elektronike që lehtë munden të verivikohet. Po ashtu në platformë elektronike është e bashkangjitur edhe lista e stafit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Pra ky kusht është i plotësuar. Edhe po të ishte kjo oferte e pa përgjegjëshme nuk do të kishte ndonjë ndikim në këtë aktivitet të prokirmit spese oferte OE të rekomanduar për kontratë është e përgjegjëshme dhe ka ofruar çmimin më të ulët. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë ofertën e përgjegjëshme me çmimin më të ulët. Oferta e OE ankues është oferta e 3 me radhë për nga çmimi sipas kriterit të dhënies së kontratës. Pra edhe dy oferta kanë çmim më të ulët se oferta e OE ankues.
Gjatë procesit të ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Qasja në dokumentet e OE fitues i është dhënë OE ankues por në dokumentacion të klasifikuar që AK e ka bërë sipas kërkesës së poltësuar të Ankesit 3 të dosjes së tenderit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Në këtë proces të vlerësimit, nuk ka shkeljet të neneve të LPP-së të përmenduar në ankesë nga operatori ekonomik ankues.
Bazuar në sqarimet e dhënë më lartë në përgjigjëjet e pretendimeve ankimor të OE ankues, eksperti shqyrtues e **Refuzon** ankesën si të pa bazuar.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues të **vazhdoj me dhënie të kontratës** për aktivitein e prokurimit **"Hartimi i Projeteve"** me nr. prok. 615-19-1401-221 në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.